



**Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE**

Qendra e jo-qeveritare e lirë DHC PDK Kosovë

Piani Shqiptar i EC eshtë i ndërtuar mbi të dhëna strategjike të cilat brenda vjetës së ardhura strategjikë që përcaktojnë në detale me të madha se si do të përmblidh dne të arrinë EC ruzionin dhe vizionin e saj, respektivisht:

- Rrja e mundësive që nuk ka që bëhet kështu me qytetarët;
- Kuptim dha evolimi mbi i mësi këtë nevojave që alternativë për përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve;
- Përmblidhje e misionit duke zhvilluar me efikasitet resurseEnjëresore që teknologjike.

EC është organizatë e komunitarit që zhvillohet për avansimin e demokracisë në nivel lokal në Kosovë. Organizata punon me një numër të konsiderueshëm grupesh të komunitetit, si që mësimdhënësit, presionistë përfershëmëndaj qeverive lokale përgjegjëse transparente dhe ligjardhëne.

Duke filluar nga janari i vitit 2015, EC funksionon me këto tri programe:

1. Qyteti Gjithëpërfshires (mobilizim i komunitetit)
2. Gjeveria e mëtej ftonies
3. Hulumtimi (praktikë lokale)

EC MA NDRYSHE

RAPORT I PUNËS 2017

Shtrirje geografike

Pokushet e EC do te hente në Prizren që Prishtinë, udhësa iniciativa të caktuara i realizuan edhe në komunitat e tjera, kryesisht ato të rajocit të Prizrenit. Sipas viteit 2015, EC ka më zotërimin e Indeksit të Transparency International që përcinë të çift kë shtrirje aktivitetin edhe në pesë komuna të tjera të mesme (Gjakova, Pejë, Gjilan, Mitrovicë dhe Ferizaj). Brenda tui vites, EC synon që përcinë Indeksin të përfshijë mbi 70% të komunave të Kosovës. Aktivitet monitorues dho mbikëqyrës i organizatës nga vitit i kaluar eshtë shtrirje e tare në komunat Dragash, Reçica, Malishevë, Suharekë dhe Shëngjin. Si pjesë e evolucioni përmirësimi e qendrave historike të Kosovës, përvèq QK Prizren, EC nga fillimi i vitit 2015 po lëvizjet e gjerë historike të Gjakovës, Prishtinës, Pejës dhe Mitrovicës. Tuhe gjithë vitin 2017 EC ka mësimdhënës përzgjedhjen e vet ne këtë program, përsërsa me projektin e sigurimit qëdo përdesë se dyte te viti 2016 ka zhvilluar aktivitetin ne 13 komuna e cila gjate vitit 2017 do vashndan përzgjedhjen e vet ne këto komuna të Kosovës.

QASJE E RE STRATEGJIKE DHE PROGRAMET

Plani Strategjik i EC-it është i ndërtuar mbi tri qëllime strategjike të cilat brenda vites kanë objektiva strategjike që përshkruajnë në detaje më të mëdha se si do të përbush dhe të arrijë EC misionin dhe vizonin e saj, respektivisht:

- Rritja e mundësive dhe njohurive për bashkëveprim me qytetarët,
- Kuptim dhe avokim më i mirë rreth nevojave dhe alternativave për përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve,
- Përbushje e misionit duke menaxhuar me efikasitet resurset njerëzore dhe teknologjike.

EC është organizatë e komunitetit që angazhohet për avansimin e demokracisë në nivel lokal në Kosovë. Organizata punon me një numër të konsiderueshmë grupesh të komunitetit, si dhe mirëmban një presion të përhershëm ndaj qeverive lokale për qeverisje transparente dhe llogaridhënëse.

Duke filluar nga janari i vitit 2015, EC funksionon me këto tri programe:

1. *Qyteti Gjithëpërfshirës (mobilizim i komunitetit)*
2. *Qeverisja e mirë (monitorim dhe avokim)*
3. *Hulumtimi (prodhim i dijes)*

Shtrirja gjeografike

Fokusi i EC do ishte në Prizren dhe Prishtinë, ndërsa iniciativa të caktuara u realizuan edhe në komunat e tjera, kryesisht ato të rajonit të Prizrenit. Gjatë vitit 2015, EC ka nis zbatimin e Indeksit të Transparency Komunale, përmes të cilit ka shtrirë aktivitetin edhe në pesë komunat tjera të mëdha (Gjakovë, Pejë, Gjilan, Mitrovicë dhe Ferizaj). Brenda tre viteve, EC synon që përmes Indeksit të përfshijë mbi 70% të komunave të Kosovës. Aktiviteti monitorues dhe mbikëqyrës i organizatës nga viti i kaluar është shtrirë edhe në komunat Dragash, Rahovec, Malishevë, Suharekë dhe Shtërpce. Si pjesë e avokimit për mbrojtjen e qendrave historike të Kosovës, përvèç QH Prizren, EC nga fillimi i vitit 2015 po i vëzhgon edhe qendrat historike të Gjakovës, Prishtinës, Pejës dhe Mitrovicës. Edhe gjatë vitit 2017 EC ka mirëmbajtur prezencën e vet në këto komuna, ndërsa me projektin e Indeksit gjatë pjesës së dytë të vitit 2016 ka zgjëruar aktivitetin ne 13 komuna ku edhe gjate vitit 2017 ka vazhduar prezencën e vet në këto komuna të Kosovës.

PROJEKTET

Gjatë vitit 2017 është punuar në shtatë projekte. Disa nga projektet ishin vazhdimësi nga viti 2016. Projektet e organizatës gjatë vitit 2017 kanë patur këtë shtrirje gjeografike brenda Kosovës: Prizren, Mamushë, Malishevë, Suharekë, Dragash, Rahovec, Gjilan, Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Ferizaj, Mitrovicë, Klinë dhe Shtërpce.

Indeksi i reformës së transparencës komunale

Indeksi është vazhdimësi e projektit “Transparenca online...”, që njëherit shënon momentin e zgjerimit të punës së organizatës në 13 komuna të Kosovës. Paralelisht monitorimit të komunave që është zgjeruar në të gjitha komunat e Rajonit të Prizrenit dhe në komunën e Shterpëces, projekt ka shtuar edhe komponentën e Indeksit, një metodologji e matjes sistematike të transparenës në trembëdhjetë komuna të Kosovës. Në prill të vitit 2017 është publikuar raporti i Indeksit me të gjetura të detajuara për trembëdhjetë komuna të Kosovës. Indeksi do të realizohet në vazhdimësi duke i monitoruar komunat edhe gjatë vitit 2018, ndërsa publikimi i raportit do të bëhet në tre-mujorin e parë të vitit 2018.

Qytetet Gjithëpërfshirëse...

Nga viti 2017, “Qytetet Gjithëpërfshirës...” ka filluar/zgjeruar punën edhe në nivel të fshatrave të Prizrenit. Gjatë këtyre muajve, projekt ka nxitur veprime në të gjitha lagjet e qytetit dhe në disa fshatara, me një numër solid rastesh që kanë gjetur zgjidhje brenda kësaj periudhe. Projekt ka qenë prezent në hapësirën publike përmes performansave, të cilat po i artikulojnë kërkesat e qytetarëve në formën e aktivizmit kulturor dhe urban. Për qëllime të projektit është ndërtuar dhe është duke u përditësuar me informacione edhe portalit *mahalla.info*, që synon të shndërrohet në adresën kryesore të informacionit mbi gjendjen në lagjet e qytetit.

Platforma Urbane e Prizrenit

Projekti synon nxitjen dhe përkrahjen e qeverisë lokale të Prizrenit për të zhvilluar një qasje të strukturuar ndaj zhvillimit të qëndrueshëm urban, që do të jetë në përputhje me Agjendën Urbane për BE-në. Përmes këtij projekti, EC synon të avokojë ndaj autoriteteve publike për iniciimin e një platforme të strukturuar të planifikimit urban dhe zhvillimor të qytetit. Projekt i synon të nxisë autoritetet lokale për të nisur ndërtimin e një platformën urbane, duke i vënë hapat e parë të hulumtimin në terren për grumbullimin e të dhënave në dy sektorë të rëndësishëm të planifikimit urban (hapësirat e gjelbra dhe monumentet brenda qendrës historike).

Transparenca e planifikimit hapesinor ne Prizren

Projekti synon hapjen e të gjitha dokumenteve të planifikimit hapësinor në komunën e Prizrenit, përfshи edhe ato që ndërlidhen me dokumentet e trashëgimisë kulturore për Qendrën Historike të qytetit. Përmes krijimit të platformës online të planifikimit hapësinor të Prizrenit synohet përbushja e obligimeve të Kartës për Hapjen e të Dhënavë si pjesë integrale e Partneritetit për Qeverisje të Hapur, si dhe rritja e nivelit të llogaridhënieve publike në njërin ndër sektorët më jotransparent dhe të përfolur për keqpërdorime në Kosovë. Hapja e të dhënavës dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor do të krijojë mundësi më të mëdha për mbikëqyrjen e punës së autoritetave publike në raport me urbanizmit, lejet e ndërtimit, planifikimin zhvillimor dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore.

Themelimi i dijes europiane ne planifikim dhe zhvillim urban

Projekti synon të mobilizojë resurset ekzistuese në Kosovë për të avokuar për politikat më të mira të planifikimit dhe zhvillim urban përmes: prodhimit dhe thellimit të dijeve europiane mbi planifikimin dhe zhvillimin urban, avokimit për një platformë të strukturuar urbane për Prizrenin dhe kontributit të shkruar për reportin e KE-së për Kosovës. Të gjitha këto forma të veprimit do t'i përbahen temës së planifikimit dhe zhvillimit urban, brenda të cilit trashëgimia kulturore (dhe planifikimi i intergruar) do të ketë vëmendje të posaçme. Projekti synon nxitjen dhe përkrahjen e qeverisë lokale të Prizrenit për të zhvilluar një qasje të strukturuar ndaj zhvillimit të qëndrueshëm urban, që do të jetë në përputhje me Agjendën Urbane për BE-në. Përmes këtij projekti, EC synon të avokojë ndaj autoritetave publike për një platforme të strukturuar të planifikimit urban dhe zhvillimor të qytetit.

Drejt një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në hartimin e politikave

Projekti implementohet nga rrejti i organizatave të shoqërisë civile Civikos në partneritet me qendrat rajonale të Civikos-it i cili përkrahet financiarisht nga Programi MATRA, menaxhuar nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Kosovë. Në këtë projekt EC është partner për rajonin e Prizrenit dhe kontribuon duke asistuar Civikos-in me ndihmë logjistike, administrative dhe duke kontribuar në monitorimin e procesit të konsultimit me publikun në bazë të ligjeve të propozuara nga organizatat e shoqërisë civile:

1. Projekligji për dhënjen në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
2. Projekligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës në Zyrën e Kryeministrit
3. Projekligji për qasje në dokumente publike, Zyra e Kryeministrit
4. Projekligji për qasje në dokumente publike, Zyra e Kryeministrit

RIKTHIMI I QYTETIT - E Drejta mbi Qytetin për grupet e nënpërfaqësuara të komunitetit në Prizren

Projekti është një përpjekje për të mbështetur grupet e nënpërfaqësuara të komunitetit që ta gjëzojnë plotësisht të drejtën mbi qytetin (dhe të drejtat e njeriut) përmes një sërë aktivitetesh dhe platformash mobilizimi të komunitetit. Projekti bazohet në përpjekjet e mëparshme të organizatës për të demokratizuar më tej ushtrimin e planifikimit urban të qeverisjes lokale të Prizrenit, duke hartuar dhe zbatuar mjete praktike për përfshirjen e komunitetit. Projektet ofrojnë mjete praktike për grupet e synuara të komunitetit, të kombinuara me alternativa të politikave dhe forcimin e proceseve demokratike institucionale.

Projekti "Rikthimi i qytetit" ka këto objektiva: 1. Të mundësojë platforma për arsim, mobilizim dhe aktivizëm përmes të cilave grupet e nënpërfaqësuara të komunitetit do të ndikojnë në planifikimin e qytetit dhe do të përpilen për të drejtën e tyre mbi qytetin, 2. Të nxisë reformën e politikave nëpërmjet një iniciative qytetare për Kartën e së Drejtës për Qytetin që do të përshtaponte demokratizimin e qeverisjes urbane dhe planifikimit të qytetit; 3. Promovimi i një debati publik të shëndoshë mbi konceptin dhe praktikat e së drejtës për qytetin nëpërmjet medias.

Iniciativat tjera

Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë (Gjykatë e Hapur)

1. Edhe gjatë vitit 2017, projekti ka vazhduar në formën e iniciativës "Gjykatë e Hapur" dhe realizohet pa përkrahje financiare. Komponentë esenciale e projektit është lehtësimi i komunikimit të grupeve të komunitetit me shërbyesit e drejtësisë. Zyra për Informim e Gjykatës tashmë operon me një numër mjetesh të përhershme të komunikimit (profilet në mediat sociale, butelini tre-mujor informues, programe 'vizito Gjykatën', etj). Edhe gjatë vitit 2017 është zbatuar programi i praktikës për studentët në Zyrën për Informim të Gjykatës, i cili realizohet në partneritet mes EC, Gjykatës Themelore dhe Universitetit të Prizrenit.
2. **Politikat kulturore lokale (RrOK Prizren)** – rrjetëzimi lokal i skenës së pavarur kulturore është ndër zhvillimet më të rëndësishme në sektorin e kulturës në Prizren. Si pjesë e këtij rrjeti, EC ka vazhduar të angazhohet për zhvillimin e politikave kulturore lokale në Prizren, që do të sigurojnë zbatim konkret të zotimeve për zhvillim ekonomik përmes kulturës të vendosura në Planin zhvillimor Komunal 2025 të Prizrenit. Një nga sukseset e rrjetit gjatë vitit 2017 ka qenë nënshkrimi dhe fillimi i draftimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit me Komunën e Prizrenit për anëtarësimin e Prizrenit në iniciativën globale Agjenda 21 për Kulturën.
3. **Kino Lumbardhi** – iniciativa për mbrojtjen e kinos ka ofruar një shembull të mirë se organizimi dhe bashkimi mund të sjellë efekte të dëshiruara. Angazhimi për Kino Lumbardhin ka vazhduar edhe gjatë vitit 2017, ndërsa gjatë kësaj periudhe është duke u punuar hartimi i planit të menaxhimit të këtij monumenti, si dhe janë kryer disa punime restauruese në objekt.

4. **Rrjetëzimet** – EC ka vazhduar të konsolidojë pozitën e vet brenda rrjeteve nationale dhe rajonale, ndërsa si pjesë e tyre ka ndihmuar në iniciativat e shoqërisë civile në nivelin qendror, përfshi zbatimin e strategjisë së bashkëpunimit mes qeverisë de shoqërisë civile (përmes Civikos), hartimin e strategjive shtetërore të kulturës dhe trashëgimisë kulturore (përmes Forumit Kulturor), etj. EC ka themeluar edhe kapitullin e Kosovës në rrjetin global INTBAU (fondacion i Princit Charles).
5. **Shkolla për Planifikim dhe Zhvillim Urban** – EC në pjesën e parë të vitit 2017 ka realizuar ciklin e tretë të Shkollës për Planifikim dhe Zhvillim Urban. Qëllimi kryesor i Shkollës së strukturuar në tri module është ngritja e nivelit të njohurisë tek pjesëmarrësit në çështjet dhe praktikat evropiane lidhur me planifikimin dhe zhvillimin urban. Gjatë vitit 2018 planifikohet të mbahet cikli i radhës i kësaj Shkolle.
6. **Bashkëorganizimi i aktiviteteve** – EC edhe gjatë fillimit të vitit 2017 ka ndihmuar organizatat e shoqërisë civile nga qytetet tjera për të realizuar aktivitete me tema të ndryshme në Prizren. Disa nga organizatat që ka bashkëpunuar në realizim të aktivitete janë: GAP, INDEP, FIQ, D4D, ATRC, YIHR.
7. Në tre mujorin e parë të vitit 2017 është bërë nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit mes EC dhe autoritetave publike, konkretisht për mënjanimin e pengesave të qasjes të identifikuara në Hartën e Barrierave (hulumtimi/produkt i realizuar në vitin 2016).

PUBLIKIMET

Gjatë të vitit 2017, organizata ka realizuar 14 katërbëdhjetë publikime, përfshi analiza, dokumente të politikave, raporte, studime hulumtuese, buletinë si dhe dy video produkte dhe gjashtë vizionime për qytetin.

Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale 2016

Indeksi është mekanizëm përmes të cilit synohet të maten indikatorët relevantë që dëshmojnë nivelin e transparencës së institucioneve të pushtetit lokal në Kosovë. Në këtë indeks, që është i pari i këtij lloji,

janë përfshirë trembëdhjete komuna të Kosovës si Prizren, Mamushë, Malishevë, Suharekë, Dragash, Rahovec, Gjilan, Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Ferizaj, Mitrovicë, Shtërpce.

publike - Siguria të informave publike* është shqyrtimi me i detajuar i shqetësimave që kërkesave të grave dhe vajzave të komunës së Prizrenit me qëllim të arritjes së propozimeve konkrete të vizionuara të cilat do të mund të adresohen në deri tek autoritetet përgjigëse.

PRIZRENI - Qytet që nuk i ka mënjanuar barrierat për PAK

Personat me Aftësi të Kufizuar në Kosovë në përgjithësi dhe në Prizren në veçanti përballen me diskriminimin shumëdimensional në baza ditore. Sfidat në qasjen në objekte e transport publik, shëndetësi, arsim, punësim, etj. Për këtë komunitet paraqesin pengesë në drejtësia të gëzimit të drejtave të garantuara kushtetuese e ligjore, gjë që bën që PAK-të të mos gjëzojnë as mundësi të barabarta si pjesëtarët tjerë të shoqërisë.

Planifikim urban për qytetarët

Kjo analizë e shkurtër mëton t'i paraqesë shqetësimet kryesore të qytetarëve të Prizrenit në lidhje me çështjet e planifikimit urban dhe menaxhimin e qytetit në përgjithësi. Analiza e prezantuar këtu është e pesta me radhë që realizohet brenda një periudhe katër (4) vjeçare në kuadër të projektit "Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren".

Shkolla për të gjithë

Edhe pse e drejta për vijim të shkollimit është e siguruar me Ligjin për Arsim në Komunat e Republikës së Kosovës, personat me aftësi të kufizuara rezultojnë ta kenë pothuajse të pamundur vijimin e shkollimit elementar. Eshte ky ligj që promovon një sistem arsimor jo-diskriminues në te cilin respektohet e drejta e secilit person për mundësi shkollimi. Madje sipas po këtij ligji, institucionet shkollore kanë për detyrë promovimin e politikave gjithëperfshirese për integrimin e personave me dobësi dhe aftësi të kufizuar në sistemin arsimor. Gjithëpërfshirja është poashtu njëra ndër prioritetet e Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional.

Numri i shtatë i buletinit "Gjykatë e Hapur"

Gjykata Themelore e Prizrenit ka publikuar numrin e shtatë të buletinit informativ "Gjykatë e Hapur", i cili mbulon periudhën Janar-Prill 2017. Buletini është një dritare e transparensës së punës së Gjykatës Themelore të Prizrenit, që synon fuqizimin e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe në punën e Gjykatës në veçanti.

Gruaja dhe hapësirat publike

Ky raport/visionim është produkt i grupit joformal të grave dhe vajzave të Komunës së Prizrenit "FEMaktiv" në bashkëpunim me OJQ "EC Ma Ndryshe". Qëllimi i punëtorisë "Gruaja dhe hapësira publike - Siguria në hapësirat publike" është shqyrtimi me l detajuar l shqetësimet e kërkesave të grave dhe vajzave të Komunës së Prizrenit me qëllim të arritjes së propozimeve konkrete të vizionuara të cilat do të mund të adresoheshin deri tek autoritetet përgjegjëse.

Numri i tetë i buletinit "Gjykatë e Hapur"

Gjykata Themelore e Prizrenit vazhdon me publikimin e rregullt të buletinit "Gjykatë e Hapur" duke shfaqur transparencën e punës së këtij institucioni. Ky dokument ka filluar të publikohet si rezultat i bashkëpunimit mes Gjykatës Themelore në Prizren dhe EC Ma Ndryshe, punë të cilën tashmë ekipi i kësaj gjykate po vazhdon ta bëjë në baza të rregullta kohore.

Kontributi i EC-it për Raportin e KE-së për Kosovën

Zhvillimet përgjatë tremujorit të fundit të vitit 2016 dhe gjysmës së parë të vitit 2017 tregojnë se mbrojtja dhe menaxhimi i duhur i trashëgimisë kulturore në tërë Kosovën mbetet një sfidë mjaft serioze. Në këtë raport i gjeni detajet e hollësishme rreth gjendjes aktuale të trashëgimisë kulturore.

Urbanizmi i mbyllur i Prizrenit

Ky raport është përgaditur në kuadër të projektit "Transparenca e Planifikimit Hapësinor në Prizren" i cili synon hapjen e dokumenteve të planifikimit hapësinor në komunën e Prizrenit, për të përmbushur obligimet e Kartës për Hapjen e të Dhënavë, dhe rritur nivelin e llogaridhënieve publike në këtë sektor

Udhëzues për transportin urban në Prizren - trabsporti publik i qasshëm për të gjithë

Dokumenti paraqet manualin e tranportit urban, i cili synon rritjen e efikasitetit të shërbimit të transportit urban, duke dhënë shembuj konkret lidhur me mundësinë e planifikimit të ndalesave të stacioneve urban bazuar në linjat aktuale, llojet e autobusëve për përshtatshmërinë e tyre për të gjitha kategoritë e komunitetit, stacionet urban të dizajnuara për kërkesat e të gjitha grupeve të komunitetit si dhe ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse.

Hapësirat Publike në Prizren

Gjatë vitit 2017 është kryer hulumtimi i të gjitha hapësirave publike të Qendrës Historike të Prizrenit. Janë analizuar kategoritë, funksionet e tanishme, elementet dhe mobilaria urbane, qasja për persona me aftesi të kufizuara, etj. Shfrytzueshmëria e hapësirave është përcaktuar pas marrjes parasysh të të gjitha faktorëve të gjendjes ekzistuese dhe shfrytëzimit të tyre në baza vjetore. Hulumtimi përmbylli me dy shtojca (1. Hartat dhe 2. Kartelat e hapësirave publike) dhe rekomandime konkrete se si të adresohen çështjet që kanë të bëjnë me ngritjen e cilësisë së hapësirave publike në qendër të qytetit.

E drejta mbi qytetin

Ky manual është produkt i dalur nga një proces gjithëpërfshirës me të rinxjtë dhe fëmijët, të cilin EC Ma Ndryshe e organizon për të përkrahur të drejtën e tyre për përfaqësim si një nga grupet më të ndërpërfaqësuara të Prizrenit. Punëtoria "E drejta e të rinjve dhe fëmijëve mbi qytetin (nga perspektiva e të drejtave të të rinjve)" është bazë e këtij dokumenti, por qëllimi i tij përtej rapotimit të të gjeturave të punëtorisë është të shërbej si manual dhe udhërrëfyes për të gjithë ne. Si fëmijë, si të rinjë, si të rritur dhe si vendimmarrës, të krijojmë qytete ku zëri i të rinjve dhe fëmijëve dëgjohet dhe idetë e tyre merren parasysh.

Gjendja fizike e monumenteve dhe sfidat e menaxhimit të TK në Prizren

Gjendja fizike e monumenteve dhe sfidat e menaxhimit të TK në Prizren. Të përshkruara janë detaje të ndryshme bashkë me fotografitë e objekteve, gjeoreferencat, statusin ligjor, periudhën e ndërtimit, statusi pronësor, potencialin e asetit për zhvillim.

Përgjegjësitë e autoriteteve komunale në planifikim urban

Në këtë raport/analizë janë paraqitur përgjegjësitë e nivelit lokal në planifikim hapësinorsi dhe janë dhënë rekomandime për funksionalizim më efikas të institucioneve.

Raporti vjetor i punës për vitin 2017 u miratua në takimin vjetor të Kuvendit të Anëtarëve të EC Ma Ndryshe, mbajtur më 28 Shkurt 2018, në Prizren

Në emër të Kuvendit të Anëtarëve
Taulant Gutaj, kryesues i Kuvendit të Anëtarëve



Në emër të stafit të organizatës
Edon Mullafetahu, drejtor ekzekutiv